



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1976 Prot

Tiranë, më 13 /12/2019

REKOMANDIM

Nr. 66, datë 13 /12/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://www.infrastruktura.gov.al/programi-i-transparences-6/>, të Autoritetit Publik "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Publikime” në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik, janë pjesërisht të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse. Disa prej *link*-eve të cituar nuk aksesojnë informacionin e cituar dhe në disa raste ndërlidhen me faqen zyrtare të ndryshme nga ajo e cituar, si dhe një pjesë e informacioneve të bërë publik kanë mbetur të pa përditësuar.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

c) informacion për procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

d) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por, të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.12.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi




Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë – datë 04.11.2019 – 08.11.2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <https://www.infrastruktura.gov.al/programi-i-transparences-6/>

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Publikime”, dhe Programi i transparencës është ndërlidhur në këtë menu.

Nga monitorimi rezulton se, Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 datë 22.01.2015 të Komisionerit. Gjithashtu rezulton se kategoritë e informacionit të programit model të transparencës, janë pjesërisht të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse. Disa prej linkeve të cituar nuk aksesojnë informacionin e cituar dhe në disa raste ndërlidhen me faqen zyrtare të ndryshme nga ajo e cituar, si dhe një pjesë e informacioneve të bërë publik kanë mbetur të pa përditësuar.



7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Informacioni i detyrueshëm për tu publikuar sipas kësaj pike, rezulton i cituar në tabelën e programit të transparencës por është pjesërisht i ndërlidhur(i pa linkuar) me programin e transparencës, një pjesë e informacionit rezulton i publikuar në rubrika të tjera të faqes;

Drepana e Programeve te Zhvillimit te
Transportit, Infrastruktura dhe Zhvillimit
Urban
Kontakt
Tel



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Njoftime Ministria Prioritete Shërbimet Bazë Ligjore Publikime Multimediale Buletini mujor

Kontakt Diaspora

Institucionet e Varësisë

A- A

f t

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Shërbimi Gjeologjik Gjeoktër
- Nisma për transparencë në industrinë naftërore
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
- Agjencia Kombëtare Dërrhamore
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
- Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit



Balluku inspekton punimet në bypass-in e Tepelenës

7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit si dhe i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;

Transportet

A- A

f t

- Udhëzimet mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore
- Raporti i kontrollit teknik
- Manuali i kontrollit të mjeteve
- VKM
- Ligjet



Balluku inspekton punimet në bypass-in e Tepelenës

I – Produktet e Ndërtimit

- Ligji Nr.9290 datë 07.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar
- VKM Nr.312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregulloreve për sigurinë në kantier"
- VKM Nr.1012 datë 10.12.2010 "Për miratimin e rregulloreve për sinjalistikë në kantier dhe në vendin e punës"

II – Transporti Rrugor

- Ligji Nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor"

Industria

A+ A **MD**

f t q

- Zhvillimet Industriale
- Siguria Teknike dhe Mbroqkyrja e Tregut
- Udhëzime dhe Urdhva të Ministrisë
- VKM
- Ligje

f t q



Balluku Inspektion punimet në bypass-in e Tepelenës

Zhvillimi Urban

A+ A **MD**


f t q


- Dokumenti i Politikave për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit në Shqipëri
- VKM
- URDHRA
- LIGJE
- UDHËZIME
- DEKRETE
- RREGULLORE
- URDHRA DHE UDHËZIME TË MZHU




Balluku Inspektion punimet në bypass-in e Tepelenës

7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. Linku i cituar në programin e transparencës është i pa aksesueshëm, por informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në rubrika të tjera të faqes, mungon informacioni mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankesë;






7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës dhe as në faqen zyrtare të autoritetit;**





7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni nuk është i publikuar, ndërkohë që rezultojnë të publikuara pjesërisht disa raporte financiare për vitet 2017 – 2018, regjistri dhe procedurat lidhur me marrjen e licencave;**



7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv)

Informacioni është pjesërisht i publikuar në faqe, linku i cituar në programin e transparencës nuk mundëson aksesin në informacion;







f t 24

- U kërkuar në Platformën e Bashkëqeverisjes, nis ndërtimi i ujësjellësit të ri të Krujës


[illegible]




7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. Informacioni është pjesërisht i publikuar në faqe, por nuk është ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës. Mungon informacioni mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankesë;



7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni është i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.**



7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; - **Informacioni nuk është i publikuar, linku i cituar në programin e transparencës nuk mundëson aksesin në informacion;**



7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni është i publikuar dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës dhe është i përditësuar.**

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– **Informacioni është i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

7.1.1) çdo informacion tjetër që gjykohej i dobishëm nga autoriteti publik. **Informacioni është i publikuar.**

